




**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME**  
**Komiteti për Politikë dhe financa**  
Nr.01-060/01-34486/22 datë: 15.12.2022



Npi – 01/429 datë: 20.12.2022

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi-01/114 të datës: 26.04.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 20.12.2022 nxjerr këtë:

**E K S T R A K T**  
**P R O C E S V E R B A L**

I MBLEDHJES SË -IX- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA  
E mbajtur më datën: 20.12.2022 (e martë) në ora 09:00 h. në sallën e Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi: z.Adnan Ademi, Anëtarët e Komitetit: z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrushi, znj.Adelina Beqaj, znj.Saniye Sadiki, dhe z.Kadri Emini. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar, z.Reshat Gashi, zyrtar për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore, znj.Valmira Hoxha, praktikante, znj.Genta Mehmeti, asistente e Kryesuesit dhe z.Shqiprim Hyseni, praktikant.

Mbledhjen e hapi, Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, i cili pasi përshtëndetë të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshmër përmblodhjet e mbledhjes.

Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

**R E N D D I T E**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 25.11.2022,
2. Diskutim për Raportin e performancës së Komunës së Shtimes për vitin 2021,
3. Propozim-Vendim për dhënien e Pëlqimit për nivelizimin dhe funksionalizimin e pjesëve të rrugëve publike në ngastrën P-01134-0 dhe P-01141-0 në Z.K-Carralevë,
4. Draft- Rregulllore për Taksa, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2023,
5. OJQ “Gjenocidi në Kosovë – Plagë e Hapur”.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin përrandin e ditës.

**\* Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht aprovoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 25.11.2022

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin përkëtë pikë.

**\*Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht miratoi, Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e KPF-së, e mbajtur më 25.11.2022.**

Pika 2

Diskutim për Raportin e performancës së Komunës së Shtimes për vitin 2021

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Para se të hapi diskutimin përkëtë pikë, tha se kami marrë një dokument nga zyrtari, z.Besnik Shala përraportin e performances të Komunës së Shtimes për

vitin 2021. Besniku më ka njoftuar se nuk mundet me marr pjesë në mbledhje për shkak të angazhimeve zyrtare që ka. Është një raport mesatar i performacës.

**z.Përparim Ramusa;** Përshëndetje, te reporti i 2021, ashtu siç e thae ti Kryesuesës është raport mesatar, gjatë mbledhjes së Kuvendit do ta elaborojmë edhe më shumë. Duke llogaritur rrëthanat kur janë kryer këto punë është raport i kënaqshëm.

**\*Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi ti rekomandoj Kuvendit miratimin e Raportit të performancës së Komunës së Shtimes për vitin 2021.**

### Pika 3

Propozim-Vendim për dhënien e Pëlqimit për nivelizimin dhe funksionalizimin e pjesëve të rrugëve publike në ngastrën P-01134-0 dhe P-01141-0 në Z.K-Carralevë,

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për këtë pikë. Këtu nuk e kemi drejtorin, e kam takuar dje dhe kam diskutuar për këtë. Ja erdhë edhe drejtori tani dhe ja jap fjalën drejtorit të DPUKGJ-së z.Grejtalb Emini, për ta prezantuar këtë pikë.

**z.Grejtalb Emini, drejtor DPUKGJ;** Mirëmëngjesi, me falni për vonesën, është bërë një kërkesë nga ky operator për stabilizim të rrugëve. Janë dy rrugë që kanë mbet shumë keq, këto dy pjesë të rrugëve janë të pa kategorizuara. Arsyja e dhënies së përlimit është se duhet mi bë funksionale këto rrugë për banorët. Ne ju kemi drejtuar Kuvendit për miratimin e pëlqimit. Këto dy rrugë janë të rëndësishme për me u kategorizuar sepse edhe ju duhen operatorit Ekonomik "Kastrioti" edhe për licencim. Ai e ka bërë një kërkesë edhe më herët në Kuvend, gjithashtu duke parë edhe kërkesën e kësaj Kompanie, që nëse nuk arrihet kjo, ne i rrezikojmë dikund 70 punëtorë me mbet pa punë. Gjitha dokumentacionet i kemi me veti edhe afatet, fotot e rrugëve, gjithashtu edhe ju e keni materialin për këtë kërkesë, nëse keni ndonjë pyetje urdhëroni.

**z.Kadri Emini;** Përshëndetje, sa i përket kësaj kërkesë po lidhna me drejtorin që tha se është në shërbim të banorëve, pyetja ime është a ka edhe kërkesë nga banorët.

**z.Grejtalb Emini, drejtor DPUKGJ;** Gjithë banorët e këtyre rrugëve nuk lëvizin në rrugët që janë në kadastër, sepse ka mbet rrugë e pa kategorizuar, por nëse nivelizohën këto rrugë do të shfrytëzohen nga banorët. Nuk ka asnje kërkesë prej banorëve, e kamë pru në Kuvend sepse e di që janë për dje e kam obligim që ta sjelli në Kuvend.

**z.Përparim Ramusa;** Drejtor e mora përgjigjen në pyetjen. Kështu që ti rekomandojmë Kuvendit për mitratim. Tetë vitet e fundit nuk i keni përkrah këto biznese, mirë që e keni kuptuar, jeni ju disa koleg të mëhershëm të juaj që çdo mbledhje i keni kundërshtuar këto biznese.

**z.Grejtalb Emini, drejtor DPUKGJ;** Na jemi parimi kundër zgjerimit të Guroreve. A jemi të kënaqur normal s'jemi të kënaqur, por infrastruktura për mos me u prishur për këtë duhet me krijuar mekanizma. Në rrugën Petrovë-Reçak, Komuna e Shtimes ka investuar, tani kjo rrugë, rrezikun që ju shkaktonë banorëve është tepër i madh.

**z.Përparim Ramusa;** Ajo që thave ne me ju bë rrugë të veçantë nuk kemi pasur kompetencë me ju bë rrugë të veçanta. I rekomandojë Kuvendit që të kaloj këtë Propozim-Vendim

**\*Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi që t'i rekomandoi Kuvendit miratimin e Vendimit për dhënien e Pëlqimit për nivelizimin dhe funksionalizimin e pjesëve të rrugëve publike në ngastrën P-01134-0 dhe P-01141-0 në Z.K-Carralevë.**

### Pika 4

Draft- Rregullore për Taksë, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2023

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Para se të hapi diskutimin për këtë pikë tha, janë disa ndryshime të këruara nga KRM "Pastërtia" Njësia në Shtime, për rritjen e qmive të disa shërbimeve. Dokumentin e keni marrë me kohë. Nuk kamë me shtuar diçka tjetër më shumë pasi ka me shkuar edhe në dëgjim publik. Kështu që t'i rekomandojmë Kuvendit miratimin e kësaj pike.

**z.Përparim Ramusa;** Unë pajtohem plotësisht me këtë, te kërkesa e KRM "Pastërtia" Njësia në Shtime, kam pyetje se a hyr kjo kërkesë në rregullore?

**z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar;** Përshëndetje, na e kemi pruar si Draft, ajo kërkesë rrjedhë nga drejtoria në fjalë. Ne do ta analizojmë, për me vendos për tarifat mbetet me u zhvillu diskutimet. Për këtë moment nuk i kamë analizuar ende këto tarifa, se kamë pa të arsyeshme të diskutohen në këtë fazë, mandej pas dëgjimit publik do t'ju vije në Kuvend finali i Draft-Rregullores.

**\*Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi që t'i rekomandoi Kuvendit miratimin e vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik për 15 ditë, Draft- Rregulloren për Taksa, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2023, me propozimin e dhënë nga Drejtoria për Shërbime Publike.**

#### Pika 5

##### OJQ “Gjenocidi në Kosovë – Plagë e Hapur”

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Para se të hapi diskutimin për këtë pikë dua të ndalem në këtë pikë. Unë kamë marrë një E-mail nga një person nga Zvicra, por edhe nga z.Reshat Mujota kam pranuar një fletushkë, që ka të bëj me këtë temë. Serbia është duke bërë të pamundurën që mos mu njohtë Gjenocidi në Kosovë. Kjo Qendra Gjenocidi në Kosovë ”Plagë e Hapur” ka bërë një kërkesë edhe te Presidenti i SHBA-së Joe Biden që me njohtë Gjenocidin në Kosovë. Prandaj e kam parë të arsyeshme me futur si pikë të rendit të ditës. Në kuadër të kësaj pike kemi nxjerrë edhe një Draft-Deklaratë, të cilën e keni marrë, ju gjatë seancës mundeni me hequr diçka por mundeni edhe me propozuar me shtuar diçka. Kjo Deklaratë është punuar në mënyrë të hapur dhe me njerëz kompetent të fushës. Gjenocidi ne e dijmë që ka ndodh edhe këtu në Komunën tonë konkretisht në fshatin Reçak, pra ju kërkoj që kjo pikë të kaloj dhe të mbështesim këtë Deklaratë dhe këtë nismë të Qendrës Gjenocidi në Kosovë ”Plagë e Hapur”. Pra ti rekomandojmë Kuvendit miratimin e sajë.

**z.Përparim Ramusa;** Ne si subjekt Politik i PDK-së përkrahim çdo nismë që e shpalos të vërtetën për krimet e bëra në Kosovë.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Po besoj që deklarata është formuluar mirë, prandaj i kisha rekomanduar Kuvendit miratimin e saj.

**\*Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi që t'i rekomandoi Kuvendit miratimin e Draft-Deklaratës për Gjenocidin e ndodhur në Kosovë me theks në Reçak.**

Pasi diskutime të tjera nuk kishte Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 09:40h.

Procesmbajtësi  
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i KPF  
Adnan Ademi